



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

---

Numri i lëndës: 2023:270663

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05693081

C.nr.462/23

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, me bashkëpunëtore Albulena Morina-Lulaj, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit: P. P, nga Klina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Lon Palushaj, avokat nga Klina, kundër të paditurit A. P, nga Klina,, me bazë juridike: pengim posedimi, vlera e kontestit: 1000 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 15.05.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET e tërhequr padia e datës 29.11.2023, e paditësit P. P, kundër të paditurit A. P, me bazë juridike: pengim posedimi, vlera e kontestit: 1000 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi me datë 29.11.2023, kundër të paditurit A. P, me bazë juridike: pengim posedimi, vlera e kontestit: 1000 euro.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 30.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë, për shkak se paditësi me të paditurin me anë të marrëveshjes gojore, janë pajtuar që i padituri ta heqë, largojë llamarinën e kulmit të garazhës së vet nga shtëpia e paditësit.

Sipas nenit 261 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se:  
*“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi” dhe “Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. . Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohej për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”,* andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 lidhur me nenin 387 par. 1 pika c dhe neni 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË**

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

C.nr.462/23, datë 15.05.2024

Gj y q t a r j a:

Fllanza Hashani

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.